



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 19.03.2019, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj– kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Raporti vjetor i Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018.
2. Shqyrtim i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2017, për projektin “Zhvillim i qëndrueshëm i zonave rurale””.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Vullnet Sinaj, Senida Mesi, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj dhe Reme Lala.

Mungojnë:

Ervin Bushati.

Të ftuar:

Juliana Latifi - Kryetare e Autoritetit të Konkurrencës

Leida Matja - Anëtare e Komisionit të Konkurrencës

Adriana Berberi - Anëtare e Komisionit të Konkurrencës

Diana Dervishi - Sekretare e Përgjithshme e Autoritetit të Konkurrencës

Indrit Reka - Drejtor Kabineti i Autoritetit të Konkurrencës

Thomas Koleka – Këshilltar në Autoritetin e Konkurrencës

Ermira Gjeçi – Zëvendësministre e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Elisa Teneqexhiu – Drejtore në Drejtorinë e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve

Pjerin Shoshi – Drejtor në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural

HAPET MBLEDHJA

Juliana Latifi – Aktiviteti i Autoritetit ka qenë shumëdimensional. Gjatë vitit 2018 ai mund të përmblihet në 23 procedura monitorimi, nga të cilat si më kryesoret mund të përmendim: tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve agroushqimore në qytetin e Tiranës; tregun e sigurimeve; tregun e shërbimit bankar; tregun e ndërmjetësimit në sigurimet përkatëse bankare; tregun e transportit ajror; tregun e ngarkim-shkarkimit në portin e Durrësit; tregun e kontrollit teknik të automjeteve e të tjerë.

Po ashtu, ka pasur 3 studime dhe hapje hetimesh të përgjithshme në sektorin e arsimit të lartë, në sektorin e profesioneve të lira dhe në tregun e shërbimit spitalor, si dhe 16 procedura hetimore të realizuara, ku më kryesoret mund të përmendim: tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinim dhe tregtim në qytetin e Tiranës; tregun e kontrollit teknik të automjeteve, tregun e ngarkim-shkarkimit në portin e Durrësit; tregun e telefonisë celulare; sektorin bankar; tregun e sigurimeve; tregun e prokurimeve publike, si dhe tregun e transportit ajror.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjatë vitit 2018, në raport me vitin 2017, pati 87 vendime të Komisionit të Konkurrencës, pra dy herë më tepër se viti i kaluar, ku mund të përmendim 8 vendime për marrëveshjet e ndaluara, 14 vendime për abuzimin me pozitën dominuese, si dhe 30 vendime, që kanë të bëjnë me autorizimin e përqendrimeve.

Viti 2018 është karakterizuar edhe nga zbatimi i vendimeve të Komisionit të Konkurrencës.

Gjatë vitit 2018 të ardhurat e derdhura në buxhetin e shtetit nga gjobat e vjela dhe nga përqendrimet, të cilat janë të autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës, kapin vlerën mbi 269 milionë lekë të rinj.

Për herë të parë masa e gjobave të vjela, së bashku me të ardhurat e arkëtuara nga autorizimin i përqendrimeve, është 3,5 herë më e lartë se buxheti i alokuar. Doja ta evidentoja këtë fakt, sepse mbas 10 vjetësh Autoriteti i Konkurrencës ka bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve të dhëna nga Komisioni i Konkurrencës dhe derdhjen e një shume të konsiderueshme të gjobave në buxhetin e shtetit.

Po ashtu, gjatë vitit 2018 veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës e ka karakterizuar përmbushja e detyrimeve, që dalin nga rezoluta e Kuvendit “Për veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017”, në zbatim të dy neneve kryesore, nenit 69 dhe 70 të ligjit “Për mbrojtjen e Konkurrencës”.

Ka vazhduar bashkëpunimi me institucionet shtetërore dhe entet rregullatore.

Së pari, nëpërmjet një vlerësimi *ex ante* dhe *ex post* të akteve nënligjore dhe ligjore apo të akteve normative.

Së dyti, në marrëveshjet e bashkëpunimit që Autoriteti i Konkurrencës ka lidhur me institucionet e tjera.

Mund të përmendim se gjatë vitit 2018 nga Autoriteti i Konkurrencës është bërë vlerësimi i 40 akteve në sektorin e energjisë, të dërguara nga Enti Rregullator i Ujit; 5 akte të vlerësuara në tregun e telekomunikacionit, të nxjerra për këshillim publik nga AKEP-i; 4 akte të vlerësuara në sektorin e ujit, të dërguara për mendim nga Enti Rregullator i Ujit; 1 projektakt, vendim i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për ndihmën shtetërore; 1 projektligj nga Kuvendi për projektin dhe godinën e Teatrit të ri Kombëtar; 1 projektvendim nga Këshilli i Ministrave, për autorizimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për lidhjen e kontratave të posaçme; 1 projektligj nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për rezervat minimale të sigurisë së naftës bruto dhe nënprodukteve të saj dhe, ashtu siç e theksova edhe më sipër, një sërë marrëveshjesh bashkëpunuese me institucionet përkatëse, me rregullatorët, që kanë impakt në fushën e konkurrencës, me AKEP-in, Entin Rregullator të Ujit, Postën Shqiptare, Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave dhe me Autoritetin e Medieve Audiovizive.

Nga ana tjetër, në përmbushje të planit kombëtar për integrimin europian, Autoriteti ka miratuar edhe 2 akte të tjera.

Së pari, udhëzimin “Për kufizimet drejtpërdrejt të lidhura dhe të nevojshme me përqendrimet”, i cili është nja akt i afruar plotësisht me njoftimin e Komisionit Europian.

Së dyti, udhëzimin “Për zbatimin e rregullave të konkurrencës në vlerësimin e marrëveshjeve të aksesit në sektorin e telekomunikacionit”.

Gjithashtu, gjatë viti 2018, në përputhje me strukturën e re, të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2017, Autoriteti i Konkurrencës ka miratuar rregulloren e re për organizmin dhe funksionimin e veprimtarisë së Autoritetit.

Në përmbushje të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit, Autoriteti ka vazhduar veprimtarinë e tij kundrejt ndërmarrjeve, të cilave u janë dhënë të drejta ekskluzive nga shteti: tregut të shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkio; tregut të shërbimit të ngarkim-shkarkimit dhe aktiviteteve të lidhura me to për mallrat rifuxho në Terminalin Lindor të Portit të Durrësit, si dhe tregut të Tirana Airport Partners.

Në të njëjtën kohë, e rëndësishme në veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018 është se ka mbajtur në monitorim tregje me fuqi të ndjeshme, që kanë një impakt të

drejtpërdrejtë në konkurrencë, siç është tregu i shërbimeve të mirëmbajtjes së pajisjeve fiskale për tregtimin e karburanteve; tregu i transportit ajror të pasagjerëve, kundrejt ndërmarrjes Austria Airlines; tregu i prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe eksportit të duhanit; tregu i qiradhënies së ambienteve për magazinim dhe tregtim të produkteve agroushqimore në qytetin e Tiranës; tregu i shërbimit bankar; tregu i importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit; tregu i aktiviteteve ekonomike që zhvillon Federata Shqiptare e Futbollit; tregu i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, si dhe tregu i shërbimit spitalor.

Nga ana tjetër, gjatë vitit 2018 është bërë i mundur forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative. Vendimet e Kuvendit kanë rritur numrin e punonjësve të Autoritetit të Konkurrencës dhe për vitin 2018, në përputhje me kërkesat e Bashkimit Europian, ka funksionuar një strukturë e re, struktura e kryeekonomistit, e cila ka zhvilluar veçanërisht analiza ekonomike dhe ekonometrike. Kjo i ka hapur rrugë Autoritetit që, në propozimet në vazhdim pranë Komisionit të Ekonomisë, të kërkojë ngritjen e kësaj strukture në nivel drejtorie.

Për sa i përket veprimtarisë në tri shtyllat kryesore të Autoritetit të Konkurrencës, kontrollit të përqendrimeve, marrëveshjeve të ndaluara dhe abuzimit me pozitën dominues, gjatë vitit 2018 mund të themi se ekonomia shqiptare është karakterizuar nga një numër i madh i transaksioneve.

Mund të themi se nga Autoriteti i Konkurrencës janë njoftuar dhe autorizuar 30 transaksione, nga të cilat 47% e rasteve të njoftuara kanë ndodhur në tregun e jashtëm, për të cilat Komisioni i Konkurrencës është shprehur me 17 vendime autorizimi dhe 33% e rasteve të njoftuara janë transaksione, që kanë ndodhur në tregun e brendshëm për të cilat Autoriteti i Konkurrencës është shprehur me 13 vendime autorizimi.

Dua të ndalem pikërisht në tregun financiar dhe atë të sigurimeve, i cili është një treg i karakterizuar, gjatë vitit 2018, nga transaksione të konsiderueshme. Pikërisht në tregun financiar kemi një transaksion të autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës për Bankën Amerikane të Investimeve dhe Bankën Kombëtare të Greqisë, i cili ka konstatuar se ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, sepse pas përqendrimit Banka Amerikane e Investimeve do të zotërojë 6% të tregut.

Po ashtu, OTP Bank me Societe Generale Albania, pikërisht në lidhje me këtë transaksion, u konstatua se ky transaksion nuk sjell ndryshim të strukturës së tregut, sepse pas përqendrimit OTP Bank, që është një bankë e re që futet në tregun bankar, do të zotërojë 6% në tregun e aktiveve e depozitave dhe 8% në tregun e kredive.

Gjithashtu, kemi përsëri një transaksion me Union Bank dhe Banka Ndërkombëtare Tregtare, pasi u konstatua se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese, sepse pas përqendrimit, Union Bank do të zotërojë 4% të tregut bankar.

Kjo është një nga sferat kryesore të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për të dalë më pas pikërisht në atë që është një shtyllë tjetër me rëndësi të aktivitetit të tij në marrëveshjet e ndaluara.

Në vitin 2018 Autoriteti i Konkurrencës ka përfunduar hetimin në lidhje me tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë e palëve të treta për produktin e TPL-së dhe ka dalë me rekomandime të rëndësishme kundrejt institucionit kryesor AMF-së si dhe kundrejt shoqërive që veprojnë në fushën e sigurimeve. Veçanërisht i ka kërkuar AMF-së, që brenda 90 ditëve, të miratojë primin e riskut për çdo kompani, sigurimin mbështetur në raportin e përgatitur nga titullari i kompanisë, duke mos miratuar dhe orientuar një prim risku të njëjtë për të gjithë tregun e TPL-ve. Po ashtu, ka kërkuar nga ndërmarrjet, që ushtojnë aktivitet në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik për përgjegjësinë palëve të treta, të ndalojnë tregtimin e policave të sigurimit të detyrueshëm në kundërshtim me përcaktimet e ligjit të tyre organik për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit.

Një hetim i rëndësishëm në fushën e marrëveshjeve të ndaluara është ajo në fushën e prokurimit publik. Në përfundim të hetimit të thelluar në lidhje me një marrëveshje në ofertë në procedurat e prokurimit publik, Komisioni i Konkurrencës ka konstatuar pavlefshmërinë e marrëveshjes së ndaluar ndërmjet ndërmarrjeve, të cilat kanë marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, si dhe ka vendosur gjoba përkatëse kundrejt dy ndërmarrjeve që kanë marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, gjobë e cila është vjelë dhe tashmë ndodhet në buxhetin e shtetit.

Po ashtu, në tregun e shërbimeve me pakicë të shërbimeve celulare ka vendosur mbylljen e një procedure të hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimit celular, si dhe dhënien e disa rekomandimeve për autoritetin përkatës AKEP-in dhe Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorit. Për mosrespektim vendimi nga dy kompani celulare, pikërisht “Vodafone Albania” SHA dhe “Telekom Albania” SHA, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur një gjobë përkatëse, e cila është ekzekutuar plotësisht.

Gjatë vitit 2018, siç e thashë edhe më sipër, janë hapur edhe hetime në tregje të ndryshme, të cilat vazhdojnë të jenë edhe për vitin 2019. Gjithashtu, kemi hetime përkatëse në tregun bankar lidhur me shërbimet që ofron sektori bankar, duke iu referuar Raiffeisen Bank, Bankës Kombëtare Tregtare Bankës “Credins” dhe Bankës Intesa San Paolo. Po ashtu, në bazë të një ankese të dërguar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare është vendosur edhe hapja e

hetimit paraprak pikërisht në lidhje me rolin që luajnë bankat në tregun e ndërmjetësimit të sigurimit të jetës dhe jo të jetës, pra në pozicionin e tyre si broker. Aktualisht jemi në fazën e hetimit të këtyre dy tregjeve.

Kalojmë një shtyllë tjetër të ligjit, që është abuzimi me pozitën dominuese. Ashtu siç e theksova edhe në fillim të këtij raporti kjo lidhet pikërisht edhe me detyrimet që Kuvendi i Shqipërisë i ka vendosur Autoritetit të Konkurrencës për të parë ato ndërmarrje, të cilat ushtrojnë ose kanë të drejta ekskluzive. Pikërisht nëpërmjet një hetimi të përfunduar është tregu i shërbimit të kontrollit teknik të detyrueshëm të mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove të tyre.

Komisioni i Konkurrencës pas një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm ka konstatuar abuzim me pozitën dominuese të ndërmarrjes “SGS Automotive Albania” dhe ka vendosur gjobitjen e ndërmarrjes për shkelje të konkurrencës në masën 5,69% të xhiros totale për vitin pasardhës 2017, gjobë e cila është ekzekutuar plotësisht nga Autoriteti i Konkurrencës dhe ka kaluar në buxhetin e shtetit. Në lidhje me këtë vendim Komisioni i Konkurrencës është duke monitoruar zbatimin e vendimit në vazhdim.

Po ashtu një vendim i rëndësishëm në lidhje me pozitën dominuese është edhe ai i transportit ajror të udhëtarëve, Kjo ka të bëjë pikërisht me “Austria Airlines”, një ndërmarrje me pozitë dominuese në tregun përkatës, e cila në bazë të vendimit të Komisioni të Konkurrencës i është ngarkuar detyrimi të paraqesë ndaj pasagjerëve të saj kushte të caktuara dhe të mos i vendosur ata në kushte të pafavorshme konkurrence në zbatim të Kodit Ajror si dhe të udhëzimit për kompensimin dhe asistencën e pasagjerëve në rastin e mospërbushjes së detyrimeve në bord të avionit, anulimit apo vonesave gjatë fluturimit. Pra, ky është një vendim, i cili aktualisht është në monitorim nga ana e Autoritetit të Konkurrencës. Po ashtu, i është kërkuar Autoritetit të Aviacionit Civil që të sigurojë një informacion të përgjithshëm për të drejtat e udhëtarëve, në mënyrë që këto të drejta të shfaqen në mënyrë të qartë dhe të dukshme brenda aeroportit me qëllim që të sigurojë që të gjithë pasagjerët e pranishëm në aeroport të informohen për anulimin e fluturimeve të tyre dhe për të drejtat e tyre.

Gjatë vitit 2018 Komisioni i Konkurrencës i është kthyer në të njëjtën kohë edhe tregut të transportit ajror. Pra, në lidhje me koncesionin që ndodhet në Tirana International Airport “Nënë Tereza”, Komisioni i Konkurrencës ka vendosur dhënien e rekomandimeve për Këshillin e Ministrave dhe OSHEE-në, si dhe u ka kërkuar Komisionit të Ekonomisë dhe Financave si dhe Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin mbështetjen për të bërë të mundur zbatimin e këtyre rekomandimeve. Mund të themi se rekomandimet e dhëna nga Komisioni i Konkurrencës kanë shërbyer si një indicie për institucionet shtetërore.

Ne e dimë se kontrata e koncesionit është vendosur në vlerësim nga qeveria shqiptare për të parë balancën ekonomike ndërmjet palëve të kësaj kontrate.

Gjatë vitit 2018 një treg, i cili është marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës dhe është shprehur me vendimmarrjen e tij është edhe tregu i rrjetit të supermarketeve “Conad”, ku Autoriteti i Konkurrencës, mes të tjerave, ka kërkuar që ndërmarrja Conad Albania sh.p.k. të shmangë çdo kufizim të konkurrencës nga aplikimi i përcaktimit të çmimeve të shitjes.

Objekt i veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës që nga viti 2017, ka qenë tregu i ngarkim-shkarkimit dhe aktiviteteve të lidhura me të, për mallra rifuxho në terminalin lindor të Portit të Durrësit. Autoriteti i Konkurrencës, i cili ka bashkëpunuar ngushtë me Ministrinë e Energjisë, në vendimmarrjen e këtij vendimi dhe në analizën që i bëri këtij tregu, në mbyllje të hetimit, i ka rekomanduar ndërmarrjes EMS Albania Port Operator, e cila ka të drejtën e koncesionit në terminalin lindor të Portit të Durrësit, të aplikojë kushtet e tregtimit të barabarta, për veprimtari tregtare të njëjta ndaj ndërmarrjeve, të cilat hyjnë në marrëdhënie kontraktore, në lidhjen e kontratave me palë të mos vendosë kushte apo detyrime shtesë, të cilat natyrën e tyre ose sipas praktikave tregtare nuk kanë lidhje me objektin e kontratave në fjalë dhe përpunimi i anijeve të kryhet sipas parimit: kush hyn i pari, shërbehet i pari.

Nga viti 2017 vazhdon monitorimi i tregut të prodhimit, grumbullimit dhe përpunimit të eksportit të duhanit.

Autoriteti ka vazhduar bashkëpunimin me Entin Rregullator të Ujit për tregun e shërbimit dhe furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura. Ky është një bashkëpunim i ri, i cili ka filluar gjatë vitit 2018 me Entin Rregullator të Ujit. Në kuadër të reformës rregullatore për ujin, ne kemi dalë me dy vendime për Ujësjellës-Kanalizime Gramsh, në bashkinë përkatëse, si dhe për Ujësjellës-Kanalizime Skrapar.

Një treg tjetër që është monitoruar gjatë vitit 2018 ka qenë tregu i qiradhënies së ambienteve për magazinim dhe tregtim të produkteve agroushqimor në qytetin e Tiranës. Në përfundim të procedurës hetimore, pra mbas një hetimi të gjatë dhe të thelluar, Autoriteti i Konkurrencës ka konstatuar që ndodhet përpara abuzimit me pozitën dominuese dhe është shprehur për vendosjen e gjobës ndaj ndërmarrjes “EKMA”, për të vendosur qiramarrësin dhe qiradhënësin në kushte të barabarta sipas dispozitave të Kodit Civil.

Një treg tjetër që është trajtuar gjerësisht nga Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2018, siç e shpreha edhe në fillim, është tregu i energjisë dhe gazit natyror. Krahas vendimeve që janë marrë për këtë treg, janë gjithsej 40 vlerësime ligjore, të cilat prekin tregun e energjisë dhe gazit natyror.

Për sa u përket hetimeve për veprimtarinë ekonomike që zhvillon Federata Kombëtare e Futbollit, të cilat janë hapur për shitjen e të drejtave të transmetimit, shitjen e biletave, transferimin e lojtarëve dhe shpërndarjen e artikujve komercial, janë në proces, pra është një hetim që vazhdon edhe për vitin 2019.

Gjithashtu, është hapur edhe hetimi për tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit të miellit, i cili ka filluar që në vitin 2018, në këndvështrimin e nivelit të çmimeve dhe cilësisë së prodhimit. Këto elemente përbëjnë kufizim, shtrëngim apo pengim të konkurrencës në kuptim të dispozitave ligjore.

Një hetim tjetër i hapur në vitin 2018, i cili vazhdon edhe në vitin 2019, është për tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, kundrejt ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania.

Pra, në vija të përgjithshme ky është aktiviteti i Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2018, ku kemi një dyfishim të vendimmarrjeve, pra janë 87 vendime të marra, dhe një vlerë prej 296 milionë lekësh të ardhura, të depozituara në buxhetin e shtetit, nga të gjitha gjobat e vitit 2018. Kjo është një arritje e Autoritetit, si për vjeljen e gjobave të vendosura gjatë vitit 2018, por edhe të gjobave të vendosura nga vendimet e mëparshme.

Në raport me sistemin gjyqësor, mund të them se të gjitha vendimet e Autoritetit të Konkurrencës janë lënë në fuqi, si nga gjykata e shkallës së parë, si nga gjykata e Apelit dhe nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

Për vitin 2019, Autoriteti i Konkurrencës do të vazhdojë të mbajë në monitorim...

Arben Ahmetaj – Për vitin 2019 do të vini vitin tjetër, prandaj nuk është e nevojshme. Faleminderit!

Dua të bëj një sqarim, sepse kam lexuar dhe dëgjuar tre shifra të ndryshme për gjobat, njëra ishte 211 milionë lekë, tjetra ishte 269 milionë lekë dhe e fundit ishte 296 milionë lekë. A mund të na thoni se cila është shifra konkrete, sepse e humba fillin me tre shifra të ndryshme?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju thatë 296 milionë në fund, prandaj mendova si u shtua edhe një 30-she rrugës.

Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Xhelilaj, i cili është relatori. Pastaj do të kalojmë në pyetje dhe komente.

Roland Xhelilaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, edhe zonjës për prezantimin që bëri!

Në mbështetje të nenit 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 24, germa “e”, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës së ndryshuar”, Autoriteti i Konkurrencës i ka paraqitur Kuvendit raportin e tij vjetor për vitin 2018.

Autoriteti i Konkurrencës ka ushtruar veprimtarinë në përmbushje të misionit të tij, për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg në dobi të rritjes ekonomike dhe mirëqenies së konsumatorëve. Aktiviteti është përqendruar në zbulimin e marrëveshjeve të ndaluara, abuzimin me pozitën dominuese, kontrollin e përqendrimeve dhe vlerësimin e një sërë aktesh ligjore e nënligjore.

Ky aktivitet, gjatë vitit 2018, është konkretizuar me 87 vendime, gati dy herë më tepër se viti i kaluar.

Duhet theksuar se gjatë vitit 2018 u vendosën 6 gjoba, pas një periudhe 3-vjeçare që Komisioni i Konkurrencës nuk merrte vendime të tilla. Gjatë këtij viti u mundësua vjelja dhe arkëtimi në buxhetin e shtetit të gjobave të vendosura nga 5 vendimet e Komisionit të Konkurrencës, të cilat lidhen edhe

me gjobën e vendosur AMC-së, me vendimin nr. 59, me vlerë 211 milionë e 522 mijë lekë.

Përveç tregjeve tradicionale, që kanë qenë objekt monitorimi apo hetimi të vazhdueshëm nga ana e Autoritetit, këtë vit bie në sy edhe monitorimi i 6 tregjeve dhe sektorëve të rinj të ekonomisë të shumëpërfolur edhe në medie dhe me impakt të drejtpërdrejtë të konsumatorët shqiptarë, si tregu i shërbimeve spitalore, sektori i arsimit të lartë, sektori i profesioneve të lira, tregu i rrjeteve të supermarketeve “Conad”, tregu i veprimtarisë ekonomike që zhvillohet nga Federata Shqiptare e Futbollit dhe tregu i qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve agroushimore të Tiranës.

Struktura dhe organika e Autoritetit të Konkurrencës, në përmbushje të rezolutës së Kuvendit dhe të rekomandimeve të progresraportit të vitit 2018, është bërë me synim forcimin e kapaciteteve administrative dhe në përshtatje me modelin e institucioneve homologe të vendeve të BE-së. Ndryshimet e bëra në këtë strukturë kanë sjellë dhe do të ndihmojnë në rritjen e eficiencës së proceseve në funksion të përmbushjes së objektivave dhe të misionit ligjor të Autoritetit të Konkurrencës.

Në funksion të advokacisë, autoriteti ka realizuar një sërë aktivitetesh, seminare, forume, tryeza të rrumbullakëta, marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe ente rregullatore, si me AKEP-in, ERRU-në, AMA-n, Postën Shqiptare etj. Falë këtij bashkëpunimi ndërinstucional dhe zbatimit të rekomandimit të Komisionit të Konkurrencës, me vendimin nr. 475, 21.09.2017 me mbylljen e hetimit paraprak në tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe dhënien e disa rekomandimeve nga AKEP-i, u bë e mundur që gjatë vitit 2018 të kemi rikthimin e paketave 30-ditore në përfitim të konsumatorëve të tregut të telefonisë celulare. Në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar, si

rrjedhje e këtyre marrëveshjeve, Autoriteti i Konkurrencës ka bërë një të tillë edhe me Kontrollin e Lartë të Shtetit, që ka rezultuar ose është aplikuar në vendosjen e gjobës ndaj ndërmarrjeve “TEA-D sh.p.k” dhe “AEK sh.p.k” për marrëveshje të ndaluara në tregun e prokurimeve publike.

Rekomandimet e dhëna nga Kuvendi janë përmbushur nga Autoriteti i Konkurrencës për sa i përket aktivitetit të vitit 2018: është forcuar bashkëpunimi me organet e administratës shtetërore dhe enteve rregullatore; janë kryer marrëveshje të reja bashkëpunimi me disa prej këtyre enteve, të cilat në veprimtarinë e tyre diktojnë konkurrencën në tregjet respektive që ato rregullojnë. Bashkëpunimi me QKB-në do të jetë i dobishëm edhe në evidentimin në kohë reale të transaksioneve të shitje-blerjes së kuotave apo të aksioneve, të cilat mund të jenë objekt/autorizim përqendrimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

Duke marrë parasysh ndikimin që ka legjislacioni, janë bërë ndërhyrje në aktet ligjore, nënligjore dhe në akte të tjera normative që janë, gjithashtu, pjesë e rëndësishme e punës së këtij Autoriteti, është monitoruar tregu me pakicë i shërbimeve celulare dhe është vlerësuar ndryshimi i strukturës së tregut pas përqendrimit.

Në zbatim të rekomandimeve të dhëna për rregullatorin AKEP dhe për ndërmarrjet që operojnë në treg, për sjelljen e këtyre ndërmarrjeve lidhur me tarifat e vendosura në paketa, si dhe duke bashkëpunuar me AKEP-in për vlerësimin e dokumenteve të nxjerra për këshillim publik nga ana e tij, meqenëse AKEP-i e ka shfuqizuar analizën e tij për tregun e telefonisë celulare me vendimin nr. 89 të vitit 2018, duke vendosur ribërjen e saj, Autoritet është në pritje të nxjerrjes për këshillim publik nga AKEP-i të analizës së tregut të telefonisë celulare për të realizuar vlerësimin ligjor.

Autoriteti ka vazhduar edhe mbikëqyrjen e tregjeve ku ushtrojnë veprimtari ndërmarrje me pjesë të konsiderueshme me fuqi tregu në rritje, si dhe ka kryer veçanërisht hetime ndaj ndërmarrjeve, të cilave u janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive. Në statusin e tij Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur edhe përmbushjen e rekomandimeve të dhëna. Sipas materialit që ju keni paraqitur, për vitin 2018 janë përmbushur 5 rekomandime, në proces janë 8, 1 është i përmbushur pjesërisht dhe të papërmbushura janë 5.

Marrëveshjet e reja të bashkëpunimit me AKEP-in dhe me AMA-n duket se kanë dhënë rezultate pozitive për sa i përket përmbushjes së rekomandimeve të Komisionit të Konkurrencës në tregjet respektive që mbulojnë. Ndërkohë, bie në sy problematika e përsëritur me ERRU-në me katër rekomandime të papërmbushura, pra asnjë rekomandim të përmbushur.

Duke vlerësuar punën e Autoritetit të Konkurrencës, rekomandimet për ju edhe në zbatim të detyrimeve të Planit Kombëtar të Integritimit Kombëtar 2018-2020, si dhe të

prioriteteve të vetë institucionit janë: mbikëqyrja me prioritet i tregjeve me sensitivitet të lartë publik e social, si tregu i shërbimeve spitalore dhe sektori i arsimit të lartë publik e privat; sensibilizimi i mëtejshëm i publikut për rolin e Autoritetit në garantimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe njohjen më të saktë të publikut me fushën e veprimtarisë së Autoritetit; ndjekja me prioritet e përbushjes së rekomandimeve në tregjet e hetuara gjatë vitit 2018, veçanërisht për kontratat koncesionare në fuqi, të cilat mund të sjellin deformime të konkurrencës në treg; vijimi i zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Integritimit European në drejtim të përafrimit të legjislacionit me direktivat europiane; rishikimi i ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, me fokus përputhshmërinë me legjislacionin e BE-së; përqendrimi në trajtimin e stafit të Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me vlerësimin e të drejtave ekskluzive dhe të veçanta, sidomos në vlerësimin e procedurave të prokurimit publik për marrëveshjet e ndaluara në oferta. Gjithashtu, të jetë më produktiv dhe më proaktiv në vlerësimin e projektligjeve dhe të njoftojë Kuvendin për vendimmarrjen e Komisionit të Konkurrencës në lidhje me çdo akt ligjor që prek parametrat e konkurrencës në fazën e shqyrtimit të tyre nga komisionet parlamentare përgjegjëse.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit! A ka ndonjë, pyetje, koment apo opinion?

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit për prezantimin!

Unë kam disa pyetje: e para, a mendoni se ndarja e legjislacionit të mbrojtjes së konsumatorit nga legjislacioni për konkurrencën është pengesë në kushtet e tregut të kufizuar që ka Shqipëria?

E dyta, nga hetimet që keni realizuar, cilin konsideroni si më rezultativ dhe çfarë konsideroni ju si arritje për vitin 2018 dhe cilat janë prioritetet për vitin 2019, një nga prioritetet që është parashikuar nga juaj?

Faleminderit!

Juljana Latifi – Ju faleminderit për pyetjet!

Së pari, në lidhje me legjislacionin, kjo ka të bëjë me strukturën dhe organizimin që ka Autoriteti i Konkurrencës. Autoriteti i Konkurrencës është një institucion, i cili vepron në bazë të një ligji, që është ligji për mbrojtjen e konkurrencës. Konsumatori nuk është pjesë përbërëse e Autoritetit të Konkurrencës, por ajo rezultati në përfundim të çdo hetimi dhe vendimmarrjeje të Autoritetit të Konkurrencës është pikërisht mbrojtja e interesave të konsumatorit.

Ajo që është më e rëndësishmja dhe do të jetë në vullnetin e ligjvënësit është në rast se ligjvënësi e shikon të arsyeshme që të inkludojë mbrojtjen e konsumatorit brenda Autoritetit të Konkurrencës, në bazë të modeleve europiane që ekzistojnë në Bashkimin European.

Lidhur me pyetjen e dytë, mund të përmend dy hetimet më të rëndësishme të realizuara, atë lidhur me koncesionarin, me kontrollin teknik që i bëhet çdo automjeti kundrejt koncesionarit SGS dhe rekomandimeve që ka dhënë Autoriteti i Konkurrencës, duke i kërkuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë liberalizimin e këtij tregu dhe në të njëjtën kohë për gjobën përkatëse që vendos kundrejt shkeljes së rregullave nga koncesionari në këtë drejtim. Një hetim tjetër i rëndësishëm i Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018, që u shoqërua me rekomandime të rëndësishme, është kundrejt tregut agrourbues, që është në qytetin e Tiranës dhe ka një pozitë dominuese. Rekomandimet që kemi dhënë për vendosjen e palëve qiramarrëse dhe qiradhënëse janë në kushtet e barabarta të një kontrate të parashikuar sipas dispozitave të Kodit Civil.

Së fundi, dua të theksoj edhe rekomandimet e rëndësishme që ka dhënë Autoriteti i Konkurrencës kundrejt koncesionarit EMS APO në tregun e ngarkim-shkarkimit në terminalin lindor të portit të Durrësit për rregullimin e këtij tregu.

Për sa u përket arritjeve, ne kemi bërë të mundur që viti 2018 të karakterizohet jo vetëm me rekomandime, por edhe me sanksione të caktuara kundrejt ndërmarrjeve, të cilat kanë pozitë dominuese në treg apo abuzojnë me këtë pozitë dominuese me gjobat përkatëse dhe me vjeljen e këtyre gjobave. Pra, kemi arritur të vjelim gjobat e vitit 2018 dhe, në të njëjtën kohë, jo vetëm ato të vitit 2018, por edhe gjobat që u përkasin viteve të shkuara. Pra, është një detyrim që Kuvendi ia kishte vendosur në mënyrë të vazhdueshme Autoritetit të Konkurrencës, që u bë i mundur në vitin 2018.

Prioritetet e punës tonë janë tregjet tradicionale, ku bën pjesë tregu i telekomunikacionit, i naftës dhe i hidrokarbureve. Aktualisht, Autoriteti i Konkurrencës, edhe në bazë të orientimeve të Komisionit European, ka hapur hetime të përgjithshme në ato që ne i quajmë tregje të reja, siç janë: tregu i shërbimit spitalor, tregu i arsimit të lartë dhe tregu i profesioneve të lira.

Ju faleminderit!

Arben Ahmetaj – Unë kam disa qëndrime lidhur me raportimin tuaj.

Së pari, dua t'ju falënderoj për detajet!

Ajo që unë dua të them është qëndrim imi personal dhe jo i komisionit. Besoj se puna e Autoritetit të Konkurrencës duhet të ngrihet në një nivel të ri, jo duke u fokusuar në fenomene të izoluar, por duke u fokusuar në fenomene që krijojnë standarde të reja.

Një nga pyetjet që patëm edhe me njëri-tjetrin këtu ishte se çfarë ka prodhuar Autoriteti i Konkurrencës në lidhje me konkurrencën e lirë në aspektin e precedentit, në aspektin e ndryshimeve, të cilat nuk janë përsëritur më. Thelbi i Autoritetit të Konkurrencës nuk është gjoba, por konkurrenca e lirë dhe e ndershme.

Ka edhe një pasqyrë tjetër, që besoj se këtë vit Autoriteti i Konkurrencës duhet ta ketë në vëmendje, në të gjithë përpjekjen që bën qeveria apo Kuvendi për të përafuar legjislacionin me direktivat e Bashkimit Europian, ku në përgjithësi teknikat në aspektin ligjor dhe teknik janë përafuar në shumë fusha.

Për sa i përket mbrojtjes së konsumatorit dhe konkurrencës së lirë, standardet ngelen ende larg nga ato që afrojnë direktivat. Unë mendoj se Autoriteti duhet të ketë iniciativë dhe promovim të direktivave, që mbrojnë konsumatorët dhe konkurrencën e lirë, në mënyrë që qeveria dhe Kuvendi të ndiejnë presion nga ana juaj si një autoritet që jo vetëm mund të investigojë dhe të dalë me penaltete, por të dalë me propozime ligjore për shkak të analizimit të fenomeneve të investiguara nga ju në të gjitha elementet, qoftë në shfrytëzimin e pozitës dominuese, qoftë në praktika që kanë shtrembëruar konkurrencën e lirë.

Ajo që unë dua t'ju kërkoj, por që do të bëjmë një mbledhje me të detajuar me anëtarët e komisionit për t'ju dërguar një letër me kërkesat tona, është që të fokusoheni sërish tek tregu i transportit ajror. Pse e kërkoj këtë?! Sepse transporti ajror, për konsekuencë gjeografie dhe zhvillim të sektorit, patjetër që ka edhe dominim të operatorëve. Po ta shikoni ka dy grupe operatorësh të mëdhenj, Alitalia dhe Star Airlines, që dominojnë në tregun shqiptar. Unë dua t'ju kërkoj Autoritetit që të bëjë diçka të vlefshme për konsumatorët dhe për tregun e lirë. Si ka mundësi që çmimi i biletave është më i shtrenjtë për segmente të ngjashme brenda Italisë apo brenda Austrisë, ndërsa çmimi i biletës në Shqipëri për segmente të ngjashme rastis dy herë? Hetimi, në kuptimin analitik, mund të kalojë edhe jashtë Shqipërisë për krahasim, në mënyrë që ju mund të dilni me dëmin e shkaktuar ndaj konsumatorit shqiptar, sepse unë ju pyeta se cili është dëmi dhe ju iu referuat gjobave. Për mua personalisht, pasi në fillim është qëndrimi im personal si deputet, si anëtar, pastaj si kryetar i këtij komisioni, gjobat janë një element i rëndësishëm, por jo thelbësor, dhe dëmi në shume dhe dëmi moral për konsumatorin është shumë i rëndësishëm. Në qoftë se ju i referoheni balancës ekonomike që është bërë për TIA-n, unë kam qenë në administrim të një ministrie dhe kam qenë pjesë e atij investigimi. Ai investigim ka të bëjë me balancën ekonomike të operimit të TIA-s si operator i aeroportit, ndërsa në lidhje me aspektin e çmimit të biletave (ne e kemi nxjerrë dëmin, por do të vijë dita që administrata do ta nxjerrë vetë në bazë të procedurës ligjore), ndërsa në aspektin e çmimit të biletave, për shkak të një tregu, i cili nuk është plotësisht i lirë dhe për shkak se kemi ende

vetëm një aeroport, dëmi i konsumatorit shqiptar mund të shkojë deri në 200 milionë euro. Çfarë bëjmë ne?! Çfarë bën autoriteti? Pastaj kuptohet se çfarë bën administrata e të tjera. Pra, besoj se duhet të futemi në tregje të qenësishme.

Tregu i medikamenteve

Të mos harrojmë që rimbursimi nga buxheti i shtetit ka shkuar në 120 milionë, pra është rreth 10,4 miliardë lekë këtë vit. Këto janë çmimet e rregulluara me tavan, por është e rëndësishme të shikohet si ka funksionuar konkurrenca; sa ka shpëtuar pacienti që përdor ilaçet apo tregu në tërësi, ose sa dëm ka, pra, kjo është shumë e rëndësishme.

Tregu bankar

Është një aspekt të gjykosh sistemin bankar, që nuk jep kredi dhe një tjetër aspekt është dëmi i konsumatorit të mundshëm, kredimarrësi shqiptar që nuk përfiton kredi. A ka arsye ekonomike?! Mund të ketë arsye ekonomike që nuk zhvillohet kredia. Patjetër arsyet ekonomike adresohen me reforma. A ka arsye procedurale, të cilat pengojnë konkurrencën e lirë dhe tregun?! Këtë nuk di ta them, sepse kjo është detyrë juaj.

Ju iu referuat SGS-së. Kur diskutohet për koncesionet, ai koncesion është turp. Koncesioni i kolaudimit të makinave është turp. Ju keni mbajtur një qëndrim, i cili është i drejtë, pra keni vendosur një gjobë të drejtë. A ka ndryshuar praktika? Pra, përveç investigimit fillestar, Autoriteti do një monitorim, deri te propozimi për prishjen e një koncesioni, sepse flasim për koncesionet, që janë bërë bolori me fjalë. A doni një koncesion që është turp?! Ky është kolaudimi i makinave. Dikush mund të thotë: pse nuk e prishët? Me të drejtë, por, po ta prishnim, do t'u ngarkonim tatimpaguesve dhe konsumatorëve me një gjyq të mundshëm një kosto 10-fishe, por Autoriteti i Konkurrencës ka detyrim që t'i skanojë. Domethënë, pyetja fillestare është: a është një praktikë monopol, që nuk përmirësoi shërbimin dhe që nuk e uli koston?! Zonja kryetare, duhet të ketë propozime konkrete për ndryshimin dhe për përmirësimin e këtij shërbimi në treg, të cilat t'ia sillni Kuvendit, i cili më pas bën rezolutën dhe ia dërgon kërkesat qeverisë.

Unë pashë edhe një element tjetër, pra investigimin që keni bërë në prokurimet publike. E kam si pyetje dhe si koment: çfarë do të thotë që keni bërë investigim në aspektin e prokurimeve publike, të prishjes së konkurrencës së lirë dhe të bashkimeve të kompanive?! Çfarë ka rezultuar? Cili ka qenë objekti i investigimit? Çfarë ka rezultuar dhe si ka reaguar administrata? A është prishur ajo procedurë dhe a është rihapur proceduara, apo thjesht jeni mjaftuar me një gjobë?

Unë do t'i përmbyll qëndrimet e mia ndaj raportimit tuaj të vitit 2018 dhe në vazhdim, kolegjisht me komisionin, do të hartojmë një letër-kërkesë. Por besoj se ka nevojë për një

investigim të detajuar të tregut të transportit ajror në aspektin e kostove për qytetarët shqiptarë, për segmente të ngjashme të të njëjtit grup operatorësh, qoftë *Austrian*, qoftë *Star airlines* apo qoftë *Alitalia*, sepse është shumë e rëndësishme të dalim, nëse ka, me një dëm të përafërt dhe të krahasuar për qytetarët shqiptarë.

Së dyti, tregu bankar është shumë i rëndësishëm. U bënë 5 vjet që kredia zhvillohet shumë ngadalë. Besoj se është në përgjegjësinë tuaj që ta iluminoni Kuvendin dhe qeverinë nëse ka arsye procedurale apo ka arsye ekonomike. Arsyet ekonomike adresohen me reforma, qoftë reforma tregu, qoftë strukturore. Nëse ka arsye procedurale, të adresohen nga një investigim dhe nga rekomandimet tuaja.

Së treti, është tregu i medikamenteve. Sot duhet të bëhet një investigim kronologjik dhe fotografik për të kuptuar çfarë ndodh në atë treg, sepse qytetarët shqiptarë, sigurisht, harxhojnë para për shkak të hallit të tyre me ato ilaçe, ndërkohë buxheti i shtetit paguan rimbursime 10,4 miliardë lekë. Prandaj, besoj se kjo meriton një vëmendje nga ana juaj, për shkak se tendenca për ta thyer me çmime atë tavan të vendosur në ligjin “Për buxhetin e vitit 2019”, meriton një investigim për të parë procedurën, çmimet dhe konkurrencën e lirë, ndoshta, edhe dëmin ose përfitimin. Shumë autoritete konkurrence, që bëjnë investigime të marrëveshjeve horizontale ose vertikale, dalin me konkluzione për dëme, për ndryshime ligjore ose për ndryshime procedurale. Me strukturën e plotë dhe mbështetjen e plotë që keni nga ky komision dhe nga parlamenti besoj se keni mundësi t’i bëni.

Unë do ta mbyll me një pyetje, pastaj t’i japim mundësi edhe zotit Bushaj të bëjë pyetjen e tij. A keni një raport monitorimi për të gjitha ato që keni dalë në konkluzione ndër vite? Pra, a mund të na thoni sa janë përgjigjur tregu, qeveria, Kuvendi me ato që ju keni konkluduar?

Juliana Latifi – Bashkëngjitur raportit vjetor, keni edhe vendimet e Komisionit të Konkurrencës për sa i përket zbatueshmërisë së rekomandimeve të Autoritetit të Konkurrencës.

Ju evidentuat faktin sa zbatohen vendimet tona. Nga pikëpamja ligjore Autoriteti i Konkurrencës nuk e ka vendosjen e gjobës qëllim në vetvete, por dhënien e rekomandimeve.

Se sa është bashkëpunuese qeveria, mund të themi se ne përpiqemi që qeveria të jetë bashkëpunuese. Çdo vendim yni, sidomos në lidhje me ato që quhen të drejta ekskluzive, që janë koncesionet, shoqërohet me dhënien e rekomandimeve përkatëse, të cilat shkojnë edhe në propozimet ligjore ose nënligjore përkatëse, ama jo vetëm në propozimet përkatëse ligjore apo nënligjore, por edhe me afate kohore të caktuara.

Siç e keni edhe në tabelën përkatëse, rezulton që këto rekomandime nuk janë përmbushur. Në rastin e Ministrisë së Energjetikës kemi kërkuar, si në rastin e koncesionit të SGS-së, ashtu edhe në rastin e koncesionit të terminalit lindor të portit të Durrësit, dhe kemi

dhënë një sërë rekomandimesh për përmirësimin e kuadrit ligjor, të cilat u adresohen akteve ligjore apo nënligjore përkatëse, por që aktualisht nuk janë marrë në konsideratë. Ndaj, Komisioni i Konkurrencës i ka përsëritur shkresat e saj kundrejt institucioneve përkatëse.

Kemi një bashkëpunim të mirë me entet rregullatore.

Arben Ahmetaj – Më falni që ju ndërpres, dua t'ju bëj një pyetje: në rastin kur qeveria refuzon të zbatojë rekomandimin e Autoritetit, cili është hapi tjetër ligjor juaji?

Juliana Latifi – Mekanizmi ligjor është që i drejtohem Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, ku kërkojmë...

Në fakt, nisur nga praktika e veprimtarisë së Komisionit të Konkurrencës, unë do të doja të falënderoja edhe ish-kryetarin e Komisionit të Ekonomisë, zotin Braçe, për mbështetjen që na ka dhënë, si komision, për të bërë të mundur zbatimin e këtyre rekomandimeve! Shpresoj që këtë mirëkuptim ta kemi edhe me ju.

Arben Ahmetaj – Sa herë i jeni drejtuar komisionit? Këto janë komente emocionale.

Juliana Latifi – I jemi drejtuar tri herë.

Arben Ahmetaj – Në rregull. Dhe sa herë komisioni i është referuar me shkrim qeverisë për këto?

Juliana Latifi – Komisioni na është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Jo juve, por qeverisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Juliana Latifi – Unë di që Komisioni për Ekonominë dhe Financat, veçanërisht në rastin e TIA, ndërsa në rastin e koncesionit të SGS-së dy herë dhe në rastin e koncesionit të EMS III i është drejtuar qeverisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – A i keni shkresat e...?

Juliana Latifi – Jo, nga komunikimi...

Arben Ahmetaj – Nuk i keni shkresat? Pra, i është drejtuar me gojë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Apo me shkrim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Juliana Latifi – Ky është bashkëpunimi që ne kemi me komisionin. Pra, kemi një detyrim ligjor, sipas ligjit të konkurrencës, ku në nenin 24 përcaktohet shprehimisht bashkëpunimi ynë....

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne e kemi shkresën që jua kemi sjellë juve.

Arben Ahmetaj – Jo, jo juve, e kisha fjalën për shkresën e komisionit ndaj qeverisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Juliana Latifi – Ajo nuk është në diskrecionin tonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Besoj që është detyra e stafit të gjejë letrat që i jemi drejtuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, mënyra e vetme ligjore është Komisioni i Ekonomisë.

Juliana Latifi – Jo, nuk është vetëm Komisioni i Ekonomisë. Ne jemi të lidhur ngushtë me komisionet përkatëse, pra...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Flas përtej parlamentit. Vetëm komisioni...?

Juliana Latifi – Jo, në të njëjtën kohë ne i jemi drejtuar edhe qeverisë, por nuk...

Arben Ahmetaj – A ka ndonjë instrument tjetër ligjor, përveç letrës suaj ose letrës së Komisionit të Ekonomisë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Juliana Latifi – Bashkëpunimi... Domethënë, ligji nuk parashikon ndonjë instrument tjetër.

Arben Ahmetaj – Ka procedurë administrative?

Juliana Latifi – Procedurë administrative?! Domethënë, në qoftë se ne i referohemi Kodit të Procedurës Administrative ose ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i bie që titullari i institucionit të penalizohet për mospërgjigjen e rekomandimeve.

Arben Ahmetaj – E keni bërë ndonjëherë?

Juliana Latifi – Nuk e kemi bërë...

Arben Ahmetaj – Nuk e keni bërë asnjëherë.

Juliana Latifi – ...asnjëherë kundrejt institucioneve shtetërore.

Arben Ahmetaj – Pse jo? Ju ka bërë presion institucioni...

Juliana Latifi – Jo.

Arben Ahmetaj – ...apo nuk e keni vlerësuar se duhej bërë?

Juliana Latifi – Në qoftë se është një praktikë që aplikohet, patjetër, do ta aplikojmë, por aktualisht nuk kemi gjetur ndonjë praktikë...

Arben Ahmetaj – Pra, deri tani nuk keni marrë asnjë demarsh administrativ ndaj drejtuesve të institucioneve, që nuk kanë zbatuar rekomandimet tuaja. Kështu?

Juliana Latifi – Normalisht... Domethënë, nisur nga praktika e Autoritetit të Konkurrencës, ne jemi munduar të kemi bashkëpunim me institucionet shtetërore.

Arben Ahmetaj – Bashkëpunimi ka rezultuar, se ju thatë që rekomandimet nuk janë zbatuar, pozitivisht, apo...? Si e gjykoni?

Juliana Latifi – Bashkëpunimi ka rezultuar pozitivisht në bazë të kërkesave tona të vazhdueshme.

Arben Ahmetaj – Sa kërkesa janë bërë dhe sa prej tyre janë zbatuar?

Juliana Latifi – Normalisht për çdo vendim...

Arben Ahmetaj – Sa kërkesa janë bërë dhe sa prej tyre janë zbatuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Juliana Latifi – Sa kërkesa...

Arben Ahmetaj – Sa kërkesa keni bërë ju dhe sa prej tyre janë zbatuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Juliana Latifi – Në çdo rast ne kemi çuar vendimin e komisionit, më pas kemi...

Arben Ahmetaj – Sa kërkesa keni bërë dhe sa prej tyre janë zbatuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Juliana Latifi – Nuk e kemi si statistikë, por në qoftë se ju e doni...

Arben Ahmetaj – Mund të na e dërgoni me shkrim sa kërkesa keni bërë dhe sa janë zbatuar?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, më falni, e ka kërkuar fjalën zoti Bushaj dhe pastaj do ta marrë zonja Mesi!

Xhevit Bushaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit edhe juve, zonja Latifi, për ekspozenë që i bëtë kësaj analize!

Pyetja ime nisur nga fakti që në Shqipëri një pjesë e konsiderueshme e krahinave dhe e fermerëve kultivojnë bimën industriale të duhanit. A është kontrolluar ndonjëherë tregtia e duhanit? Si janë rezultatet?

Së dyti, përsëri me zonën rurale dhe fermerët, a është kontrolluar ndonjëherë nga Autoriteti i Konkurrencës tregtia e inputeve bujqësore, plehrave kimike dhe farave?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ekziston tregtia e lirë, apo...? Cilat janë rezultatet në qoftë se është kontrolluar?

Faleminderit!

Juliana Latifi – Po e filloj nga pyetja e dytë, duke ia lënë...

(Diskutime në sallë)

Arben Ahmetaj – A mund të mbani qetësi, sepse po flet kryetarja? Ju lutem!

Juliana Latifi – ...përgjigjen e pyetjes së parë sekretares së Përgjithshme, e cila ka edhe jetëgjatësi më të madhe pranë Autoritetit të Konkurrencës për sa i përket tregtisë së duhanit.

Në përgjigje të pyetjes suaj të dytë, mund të them se Autoriteti i Konkurrencës nuk mund të ndërhyjë për çdo treg, por vetëm atëherë kur kemi të bëjmë me pozitë dominuese apo me marrëveshje të ndaluar.

Për sa i përket tregut të farërave, që ju e prekët si çështje të dytë, nga monitorimi i këtij tregu, ne kemi parë se nuk rezulton që ndërmarrjet, të cilat operojnë në këtë treg, të kenë pikërisht atë që ne e konsiderojmë marrëveshje të ndaluar apo të kenë abuzuar me pozitën dominuese. Pra, ligji na kufizon në dy sfera.

Së pari, Autoriteti ndërhyt në rast se ndodhemi përpara një abuzimi me pozitën dominuese.

Së dyti, Autoriteti ndërhyt në rast se ndodhemi përpara një marrëveshjeje të ndaluar.

Aktualisht, nuk kemi gjetur shenja abuzimi apo rast të marrëveshjes së ndaluar.

Në lidhje me tregtinë e duhanit, sekretarja e Përgjithshme mund të japë një pasqyrë edhe të ndërhyrjeve ndër vite të Autoritetit të Konkurrencës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Më falni, një sekondë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për pyetjen e zotit Xhevit do të përgjigjet sekretarja e Përgjithshme, apo jo?

Juliana Latifi – Në të njëjtën kohë, duke qenë se tregu i duhanit ka qenë në hetim dhe monitorim të vazhdueshëm ndër vite nga Autoriteti i Konkurrencës dhe sekretarja e Përgjithshme është personi që ka jetëgjatësinë më të gjatë në këtë institucion dhe di të gjithë historinë, mund të themi që Autoriteti i Konkurrencës i ka krijuar precedentët e veta dhe ka një vazhdimësi për sa i përket aktivitetit.

Arben Ahmetaj – Po, zonja Dervishi.

Diana Dervishi – Për sa i përket tregut të duhanit, ai ka qenë disa herë objekt hetimi nga Autoriteti i Konkurrencës. Ndër vite ka qenë një kompani me pozitë dominuese, e cila është hetuar nga Autoriteti i Konkurrencës, por në vitin 2017, me hetimin e realizuar, është parë që kjo shoqëri është në faliment. Bëhet fjalë për shoqërinë “Mika Korça”.

Ndërkohë, Autoriteti i Konkurrencës ka bërë një vlerësim ligjor të akteve që funksionojnë për prodhimin dhe tregtimin e duhanit, si dhe ka bashkëpunuar me Ministrinë e

Bujqësisë duke kërkuar nga ajo ndryshime ligjore. Në momentin që janë propozuar këto ndryshime ligjore, nga Ministria e Bujqësisë është dhënë suporti për të pranuar rekomandimet e Autoritetit dhe për t'i propozuar ato si ndryshime ligjore. Ndërkohë, janë propozuar dhe miratuar nga Kuvendi këto ndryshime ligjore. Ne e kemi në monitorim këtë treg për të parë çfarë do të ndodh pas këtyre ndryshimeve.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Po, zonja Mesi.

Senida Mesi – Përshëndetje të gjithëve!

Në fakt, e kam lexuar me detaje raportin dhe ju përgëzoj për rezultatin e vitit 2018 po ta krahasojmë me vitet e mëparshme!

Për të qenë në të njëjtën linjë me ato që tha kryetari, ne presim shumë më shumë prej jush, sidomos duke parë shumë zonja në drejtimin e Autoritetit, si dhe kam besim në të dy linjat kryesore që do të ndiqen gjatë vitit 2019.

Shikoj që rezultati më i mirë, qoftë edhe nga implementimi i gjobave, por edhe i rekomandimeve, shkon në dy linja kryesore për vitin 2018: e para, janë kompanitë telefonike dhe e dyta shërbimet me pagesë që janë me koncesion ose pozita dominuese. Do të ishte e udhës që në këtë linjë ju të ndërtoni një plan në lidhje me monitorimin dhe kontrollin për vitin 2019 për të gjitha ato koncesione dhe shërbime që janë me pagesë për konsumatorin, që kanë pozita dominuese apo të identifikojmë ato lloj aktivitetesh që deri diku kanë pozita apo vlerësohen si antikonkurrese. Kjo për të siguruar atë që ju keni rekomanduar për shërbimin që ofron sot SGS, që është një liberalizim i tregut, për të parë nëse kemi në treg (ka në treg) shërbime koncesionare me pagesë, të cilat në një farë mënyre kushtëzojnë apo bëjnë që konsumatorët të paguajnë më shumë nga sa mund të ishte nesër çmimi i tregut dhe eliminojnë konkurrencën e ndershme, si dhe për të shkuar drejt liberalizimit të tregjeve të kontrolluara dhe monitoruara, sikurse e parashikon ligji, prioritetet e qeverisë apo të ministrive përkatëse. Dua të shpreh personalisht, por besoj edhe nga komisioni, të gjithë garancinë dhe mbështetjen për punën tuaj.

Unë vlerësoj shumë të rëndësishme jo vetëm rekomandimet, por që t'i rrimë rekomandimeve, me qëllim që ato të zbatohen dhe që të gjitha bizneset nga njëra anë apo konsumatori nga ana tjetër të përfitojë nga konkurrenca e ndershme. Në fund të ditës konkurrenca e ndershme nuk do të bëj thjesht liberalizimin e çmimeve, por do të ofrojë shërbimet më cilësore dhe me çmimin e tregut.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Po, zoti Angjeli. Besoj se do të jeni i fundit që keni pyetje apo komente?

Anastas Angjeli – Duke parë raportin, ndjekur diskutimet dhe raportimin e kryetares, padyshim dua të them që ka progres në krahasim me një vit apo disa vite më parë në punën që Autoriteti i Konkurrencës po bën në zbatim të kuadrit ligjor që ka për të minimizuar shtrembërimet që i ndodhin konkurrencës së ndershme në tregjet e vendit tonë. Kam dy sugjerime:

Së pari, kam përshtypjen që duhet të ecim me kushtet e reja të krijuara të tregjeve në Shqipëri. Ka një mospërputhje midis kuadrit ligjor ekzistues, veprimtarisë, e cila nuk del dot nga kuadri ligjor ekzistues dhe tregjeve të reja të krijuara në vendin tonë. Ligji është bërë në vitin 2003, kur isha unë me Adrianën, i është bërë një përmirësim në vitin 2010 dhe kemi 10 vjet me atë ligj dhe me aktet nënligjore. Gjatë këtyre 10 vjetëve kanë ndodhur ndryshime në ekonominë shqiptare, në tregjet shqiptare dhe padyshim kanë ndodhur edhe ndryshime në legjislacionin shqiptar rreth këtyre tregjeve dhe rreth këtyre të rejave që kanë ndodhur. Parë në këtë këndvështrim, përveç punës së mirë që keni bërë, që keni nxjerrë 87 vendime, ka ardhur koha që me qeverinë ne të krijojmë një kuadër ligjor që i përshtatet kushteve të reja të zhvillimit ekonomik. Reflektimi në këtë drejtim i të gjitha palëve do të ishte në ndihmë të punës së institucionit tuaj.

Së dyti, ju e përmendët kur raportuat, kryetari e tha gjithashtu, kam përshtypjen që duhen parë, në aspektin ligjor, por edhe në aspektin e zbatimit konkret të rekomandimeve që ju i jepni, të dyja anët e medaljes. Njëra është ana e zbatimit të ligjit dhe e goditjes së shtrembërimeve që i bëhen tregut nga subjekte të veçanta dhe nga ana tjetër duhet parë ana e konsumatorit. Nuk jam i sigurt nëse ka një vështrim direkt mbi këtë çështje qoftë ligjor, qoftë konkret. Pra, nisemi gjithmonë për të parë nëse iks apo ipsilon subjekt dhe nuk duhet të merremi me emrat, se edhe ata e kanë të drejtën e tyre për të ruajtur konfidencialitetin dhe gjithë të tjerat. Çfarë do të kemi, mund t'i diskutojmë në një mbledhje më të mbyllur.

Shkojmë direkt te gabimi që ka bërë ai pa marrë në konsideratë dëmin që ka shkaktuar ky gabim te konsumatori. Kjo mbase ka nevojë që të rregullohet edhe në ligj, edhe në kompetencën që ju jepet juve për këtë çështje.

Unë shpresoj se me punën që keni bërë deti tani dhe me bashkëpunimin që duhet të krijojmë për të bërë një kuadër ligjor dhe një zbatim të ri në kushtet e tregjeve të reja të zhvillimit të vendit, ky autoritet do të luajë një rol më të madh, më të rëndësishëm për të minimizuar shtrembërimet që i ndodhin tregut.

Faleminderit!

Suksese!

Jeni që të gjithë shumë të mirë.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Urdhëroni!

Juliana Latifi - Desha të bëja një parantezë.

Ju falënderoj, zoti Angjeli!

Për sa i përket kuadrit nënligjor që evidentova, Autoriteti i Konkurrencës ka përafruar çdo akt, që vjen nga Ministria e Integritimit në bazë të Planit Kombëtar për Integrimin Europian, i cili parashikohet shprehimisht në këtë plan. Asnjë akt nuk ka kaluar pa u miratuar nga Autoriteti i Konkurrencës. Çdo vit në Planin Kombëtar për Integrimin Europian propozohen 2-3 akte, të cilat jo vetëm propozohen nga ministria përkatëse, por në të njëjtën kohë propozohen edhe nga vetë Autoriteti i Konkurrencës, duke parë direktivat e BE-së në fushën e konkurrencës, e cila është fusha më dinamike.

Ajo që është më e rëndësishme, në prioritetet e vitit 2019 vetë Autoriteti i Konkurrencës dikton nevojën e rishikimit të ligjit, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2003, është amenduar në vitin 2010 dhe ne kemi kërkuar nga Kuvendi, nga komisioni përkatës, mbështetje për të bërë ndryshimet e nevojshme ligjore për t'iu përshtatur, qoftë direktivave të BE-së, qoftë zhvillimeve që kanë dalë nga veprimtaria jonë.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Një qëndrim përfundimtar për të kaluar më pas në procedurën përmbyllëse.

Besoj se siç iu referuat Komisionit të Ekonomisë, jo vetëm duhet t'i kërkonit këtij komisioni, por ju mund të propozoni ndryshime ligjore. Unë do të prisja që brenda muajit prill ju të sillni propozimet për ndryshime ligjore që komisioni t'i analizojë, të bashkëpunojë me qeverinë dhe të ecim në vazhdimësi me përmirësimet ligjore, që ju iu referuat.

E dyta, me traditën që është krijuar, unë do ta kërkoj sërish nga ju dhe nga kolegët deputetë, që ta fusim edhe në rezolutën që do të shoqërojë raportimin tuaj, që veprimtaria juaj të kalojë në një nivel më të avancuar duke u fokusuar te tregjet kryesore që prekin.

Problematika është e madhe. Mundësia juaj për të investiguar çdo gjë është joekzistente. Mundësia juaj për të investiguar, analizuar, skanuar sektorë dhe tregje, që prekin më shumë konsumatorin, sigurisht është më e madhe nëpërmjet fokusimit dhe besoj se edhe nëpërmjet rezolutës do të kërkojmë fokusim.

E treta, është pjesa e monitorimit.

E katërta, është që së bashku me ndryshimet ligjore ta bëjmë Autoritetin e Konkurrencës më të fortë në përfaqje me qeverinë. Në kuptimin që diskutuam së bashku pak më parë, pra nëse një pjesë e administratës, një administrator refuzon të plotësojë rekomandimet, të cilat nuk janë rekomandime për teka, por janë rekomandime si rrjedhojë e praktikave më të mira të tregut të konkurrencës, apo siç iu referuat edhe ju, të direktivave të BE-së, që janë pjesa ligjore dhe procedurale më dinamike në BE.

Unë i sugjeroj komisionit që ta mbyllim dëgjuesën dhe raportimin dhe të kalojmë në përgatitjen e rezolutës me ato rekomandime që ne përmendëm.

Në fund draftrezoluta do t'i kalohet të gjithë anëtarëve të komisionit dhe besoj edhe Autoritetit për të na ndihmuar për të formatuar së bashku një rezolutë sa më korrekte, sa më kërkuese dhe sa më ndihmëse për Autoritetin e Konkurrencës. Besoj se deri në fund të prillit autoriteti do të na ketë dërguar ndryshimet ligjore për të avancuar më tej me kompetencat tuaja dhe me ndryshimet dinamike që ka tregu sot.

Faleminderit!

Sekretar

Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit

Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 19.3.2019, ora 11.30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – Kryetar i komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2017 për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale””

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Anastas Angjeli, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Vullnet Sinaj, Senida Mesi, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Reme Lala,

Mungojnë: Ervin Bushati

Të ftuar:

Ermira Gjeçi – Zëvendësministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Elisa Teneqexhiu – Drejtore është Drejtorja e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve

Pjerin Shoshi – Drejtor është Drejtorja e Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural

Arben Ahmetaj - Kalojmë në shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës, në shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2017 për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale””

Sot kemi ftuar zonjën Ermira Gjeçi, zëvendësministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zonjën Elisa Teneqexhiu, drejtore nga Drejtoria e Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve dhe zotin Pjerin Shoshi, drejtor i Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural.

Ju falënderojmë për prezencën!

Ky është një projektligj shumë i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë, kështu që do t’ju kërkoja që të ishit sa më koncizë dhe sa më të shpejtë.

Ermira Gjeçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Bëhet fjalë për një financim në shumën dy milionë euro prej qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë me implementues GIS-in, në formën e një granti.

Angazhimi i Këshillit të Ministrave është rimbursimi i TVSH-së në masën 200 mijë euro. Afati kohor i këtij financimi është 2 vjet.

Më 27.12. 2018 u nënshkrua marrëveshja për bashkëpunimin teknik 2017, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë. Në nëntor të vitit 2018 është zhvilluar takimi negociues për zhvillimin e bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Gjermanisë, ku qeveria gjermane merr angazhimin për shtesë në financim në masën 8 milionë euro të tjera për këtë projekt. Pala shqiptare, si kosto bashkëfinancimi, angazhohet me mbulimin e vlerës për rimbursimin e TVSH-së, sikurse e përmenda, në masën 200 mijë euro. Ky financim do të adresojë sfidën e konsolidimit dhe orientimin e bujqësisë shqiptare drejt një bujqësie më konkurruese dhe në të njëjtën kohë do të mundësojë sipërmarrje aktive në sektorët jobujqësorë si agroturizmi dhe turizmi rural. Projekt kryesisht është asistencë teknike dhe fokusohet në katër shtylla kryesore:

E para, hartimi dhe implementimi i strategjisë dhe politikave për zhvillimin rural, mbështetje për zhvillimin e strategjive dhe politikave në përputhje me kërkesat e BE-së, duke e rritur edhe përthithjen e fondeve tek IPARD-i.

E dyta, është promovimi i zinxhirit të vlerës së produkteve tipike në zonat e caktuara. Përzgjedhja e produkteve do të ketë orientim ndaj tregut, produkteve tradicionale ose produkteve të turizmit rural.

E treta, është përmirësimi i edukimit dhe forcimi i dijeve në bujqësi dhe turizëm rural. Në këtë pjesë, nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë, do të jenë përfitues AZHBR-ja dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe në mënyrë indirekte edhe fermerët.

E katërta, rritja e kapacitetit dhe njohurive në bujqësi dhe zhvillim rural. Kjo është mbështetje ndaj shërbimit këshillimor, shoqërisë civile, organizatave e të tjera, me një fokus të veçantë inovacioni në bujqësi.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Unë si referues nuk kam nevojë të përsëris ato që tha zonja zëvendësministre.

Ka pyetje apo komente? Nuk ka.

Faleminderit!

Kalojmë në votimin në parim. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Pasdite të këndshme!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar

Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit

Elvi Prifti